



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 41/31 Prot.

Tiranë më, 11/07/2023

V E N D I M

Nr. 34 datë 11.07.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

<b>Denisa Sina</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Suela Bulku</b>	<b>Relator</b>
<b>Arben Sefaj</b>	<b>Anëtar</b>

Asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Ledjana Azemaj, më datë 04.07.2024, ora 10:00, në Tiranë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I VLERËSIMIT:**

**Z. Dritan Hazi Malaj**, me funksion Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër

**OBJEKTI:**

**Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,**

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të relatores së çështjes, Znj. Suela Bulku, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Z. Dritan Malaj, i cili në seancë dëgjimore kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

### **V Ë R E N:**











#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, **Z. Dritan Malaj** është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si “Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër”
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Dritan Malaj**, i’u nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. \*\* datë 14.07.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit, e përbërë nga: Znj. Suela Bulku (Relatore), Znj. Denisa Sina (Kryesuese) dhe Z. Arben Sefaj (Anëtar).
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr. \*\* datë 14.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Dritan Malaj**.


6. Relatori i çështjes, Znj. Suela Bulku, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar, datë 14.07.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Më datë 17.07.2023, në zbatim të nenit 33/1, nenit 42 dhe nenit 46, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, janë dërguar formularët e administruar nga ana e relatorit, pranë institucioneve ndihmëse, e konkretisht:
  - ✓ Me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 17.07.2023, është dërguar formulari i deklaramit të pasurisë, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit.
  - ✓ Me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 17.07.2023, është dërguar formulari i deklaramit të aftësive profesionale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
  - ✓ Me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 17.07.2023, është dërguar formulari i deklaramit të kontrollit të figures, pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.
8. Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, në datën 29.07.2023, duke shprehur se **nuk është** në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
9. Relatori i çështjes, në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
  - ✚ Vlerësimin e pasurisë;
  - ✚ Kontrollin e figurës;
  - ✚ Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
  - a. Ligji nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
  - b. Ligji nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”


- c. Ligji nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”
- d. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15 datë, 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklaramit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’ i ndryshuar
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”

Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

-  *Deklarata e Pasurisë,*
-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaramit,*
-  *Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI*
-  *Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP*
-  *Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH*
-  *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*
-  *provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*
-  *ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

13. Trupa e vlerësimit, më datë 13.06.2024, pasi dëgjoi relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Dritn Malaj, me Vendimin nr. \*\* datë 13.06.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Dritan Hazir Malaj;**
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
  -  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*

 *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraparak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

15. Në datën 01.07.2024, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 04.07.2024, në orën 10:00, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.


## **II. SEANCA DËGJIMORE.**

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Dritan Malaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 12.04.2024, subjekti i vlerësimi z. Dritan Malaj kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 11.07.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT**

Subjekti i vlerësimit z. Dritan Malaj, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur ka qenë e nevojshme, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

 Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

- ✚ Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Dritan Malaj**, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. \*\* indexi, viti 2023.
- ✚ Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit, kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- ✚ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
- ✚ Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaramet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

#### **Hetimi administrativ konsistoi në:**

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

#### **Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI:**

ILDKPKI, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar raportin nr. \*\*\*, datë 18.01.2024, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Dritan Malaj, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, është konstatuar se:

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

Dritan Malaj, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI, në vitin 2004, me numër indeksi 2412 dhe sipas deklarimit online me numër indeksi 2462. Në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, dt. 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë, si më poshtë:

- Para fillimit të detyrës 2004
- Periodike/Vjetore 2004
- Periodike/Vjetore 2005
- Pas largimit nga funksioni 2006
- Para fillimit të detyrës 2014

## **DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT- DRITAN MALAJ**

### **DEKLARIMI I PASURIVE**

*Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr 12/2018, i ndryshuar, si vijon:*

1. Gjendja aktuale në llogarinë personale. Shuma 1.675.499,30 lekë.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Nxjerrje llogarie datë 23.02.2023, nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se, Dritan Malaj ka llogari page, me gjendje në datë 31.01.2023 në shumën 1.675.499.30 lekë.

#### **Hetimi administrativ**

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Dritan Malaj, ka llogari page me gjendje në datë 06.03.2023, në shumën 1.880.181 lekë.
- Konstatohet: Gjendja e llogarisë në Raiffeisen Bank është krijuar duke filluar nga viti 2020, me burim kursime nga të ardhurat nga puna në Policinë e Shtetit.

- **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Raiffeisen Bank konfirmon gjendje llogari page, në datë 06.03.2023, në shumën 1.880.181 lekë.**

### **DEKLARIMI I TË ARDHURAVE**

2. Të ardhura nga paga/dieta/shpërblime, në funksione të ndryshme në Policinë e Shtetit, nga periudha e fillimit në punë, 16.08.2001 e deri në datë 12.04.2005, sipas të dhënave nga borderotë me vërtetimin nr. \*\*\*, datë 02.03.2023, i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Shuma 1.859.898 lekë.
3. Të ardhura nga paga/dieta/shpërblime të ndryshme në Policinë e Shtetit nga periudha 12.04.2005 deri aktualisht, sipas vërtetimit bankar nr. \*\*\*, pr. \*\*, datë 28.04.2018 dhe vërtetimit bankar datë 23.02.2023, me vërtetim bankar datë 27.02.2023. Shuma 21.824.892 lekë.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 02.03.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, që konfirmon se z. Dritan Malaj, për periudhën 16.08.2001 deri në 30.04.2005, ka realizuar të ardhura neto nga pagat në shumën rreth 1.174.577 lekë. Gjithashtu, për periudhën 16.08.2001 deri në 30.04.2005, ka përfituar të ardhura të tjera nga diferenca page, leje vjetore, shpërblime, orë suplementare, ditë festash dhe pushimi, në shumën rreth 322.319 lekë.
- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 02.03.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë që konfirmon se z. Dritan Malaj për periudhën 01.01.2006 deri në 19.02.2007, ka realizuar të ardhura neto nga pagat në shumën rreth 526.171 lekë. Gjithashtu, për vitin 2006, ka përfituar të ardhura të tjera nga diferenca page, leje vjetore, shpërblime, orë suplementare, ditë festash dhe pushimi, në shumën rreth 73.283 lekë.
- Vërtetim datë 27.02.2023 nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se Dritan Hazir Malaj me nr. klienti \*\*\*, ka llogari rrjedhëse në lekë dhe për periudhën e viteve 2005 - shkurt 2023, i janë kredituar në llogari rreth 21.824.893 lekë.
- Nxjerrje llogarie datë 23.02.2023 nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se Dritan Malaj ka llogari page dhe për periudhën 19.11.2018 - 02.02.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat, dietat etj., në shumën rreth 6.002.331 lekë.

#### **Hetimi administrativ**

- ✚ **Raiffeisen Bank** me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 10.08.2023, përcjell CD që konfirmon se Dritan Malaj, ka llogari page dhe për periudhën 03.05.2005 - 02.03.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat, shpërblime, dietat, honorare etj., në shumën rreth 20.546.230 lekë.



- ✚ **ISSH** me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, konfirmon se Dritan Malaj për periudhën dhjetor 2012 - mars 2023, ka përfituar të ardhura neto nga paga nga Drejtoria e Forcës së Posaçme, Drejtoria e Policisë së Qarkut, Drejtoria Vendore e Policisë Kukës, Drejtoria Vendore e Policisë Fier, Drejtoria e Antiterrorit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Dibër.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, konfirmon se i ka dërguar shkresat Drejtorisë së Arkivit Qëndror Lundër, për të konfirmuar të ardhurat e realizuara nga shtetasi Dritan Hazir Malaj, për periudhën para vitit 2012.
- ✚ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qëndror**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.08.2023, nuk konfirmon të dhëna për periudhën 1994 - 2012, për shtetasin Dritan Hazir Malaj.
- ✓ **Të ardhurat neto të subjektit nga paga, shpërblimet, dietat, honorare, etj., për periudhën gusht 2001 - mars 2023, konfirmohen në shumën totale rreth 22.043.000 lekë.**

### **DETYRIME FINANCIARE**

4. Raiffeisen Bank, overdraft. Shuma 250.000 lekë.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim datë 27.02.2023, nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se Dritan Hazir Malaj, me nr. klienti \*\*\*, ka llogari rrjedhëse në lekë në të cilën janë disbursuar kredi si vijon: Në datë 18.10.2006 ka marrë kredi në shumën 350.000 lekë, e cila rezulton e mbyllur në 05.12.2008; Në datë 05.12.2008 ka marrë kredi në shumën 500.000 lekë, e cila rezulton e mbyllur në 05.12.2015. Në datë 22.04.2013 ka marrë kredi në shumën 62.900 lekë, e cila rezulton e mbyllur në 22.04.2015.

#### **Hetimi administrativ**

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Dritan Malaj, ka llogari overdrafti me limit 250.000 lekë. Gjithashtu, Dritan Malaj, ka marrë kredi si vijon:
  - Në datë 18.10.2006, i është disbursuar kredi në shumën 350.000 lekë;
  - Në datë 05.12.2008 i është disbursuar kredi në shumën 500.000 lekë;
  - Në datë 22.04.2013 i është disbursuar kredi në shumën 62.900 lekë;
- Në proces verbalin e datës 01.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaroi se overdraftin në Raiffeisen Bank e ka marrë në vitin 2018 në shumën 240.000 lekë dhe i është ofruar nga banka, pasi vetë subjekti nuk kishte qëllim për të marrë overdraft. Ka pranuar të marrë overdraft në Raiffeisen Bank, për të pasur gjendje likuiditetesh në llogari për shpenzime të paparashikueshme. Sqaroi se, aktualisht, gjendja e llogarisë së pagës është pozitive dhe overdrafti me limit të ndryshuar në shumën 250.000 lekë është i pa prekur.

Subjekti sqaroi se, qëllimi i marrjes së kredive në Raiffeisen Bank ka qënë për nevoja personale të familjes dhe nevoja mjekësore për babain e tij Hazir Malaj. Në vitin 2008, babai i subjektit Hazir Malaj ishte i sëmurë dhe ka ndërruar jetë në vitin 2015. Nuk ka ruajtur kontratat e kredive të sipërcituara, pasi kanë kaluar shumë vite dhe këto kredi janë shlyer nga subjekti me të ardhurat nga pagat.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjën e Raiffeisen Bank.**
- ✓ **Subjekti sqaroi qëllimin e kredive personale konsumatore, të marra ndër vite, të cilat rezultojnë të shlyera me të ardhura nga pagat.**

### **SHPENZIMET E DEKLARUESHME**

❖ Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022

5. Shpenzime qera banese. Shuma 24.000 lekë (dyqind e dyzetmijë).
6. Shpenzime për ujë, drita. Shuma 72.000 lekë (shtatëdhjetë e dymijë).
7. Shpenzime për telefon. Shuma 12.000 lekë (dymbëdhjetë mijë).

✚ **FSHU**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.08.2023, konfirmon se shtetasi me gjeneralitetet Dritan Hazir Malaj, për periudhën deri në datë 06.03.2023, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë furnizimi me energji elektrike.

Me gjeneralitetet Dritan Malaj, për periudhën deri në datë 06.03.2023, rezultojnë të jenë lidhur 10 (dhjetë) kontrata për shërbimin e furnizimit me energji elektrike, si vijon:

1. Nr. kontrate \*\*\*, Molisht, me instancë Berat - 11;
2. Nr. kontrate \*\*\*, Naftëtari 2, me instancë Fier - 41;
3. Nr. kontrate \*\*\*, me instancë Fier - 41;
4. Nr. kontrate \*\*\*, Vreshtas, me instancë Fier - 41;
5. Nr. kontrate \*\*\*, "11 Janari", me instancë Fier - 41;
6. Nr. kontrate \*\*\*, me instancë Vlorë - 40;
7. Nr. kontrate \*\*\*, Gjuraj, me instancë Shkodër - 82;
8. Nr. kontrate \*\*\*, Sh. Dishnica, me instancë Tirana 2 - 91;
9. Nr. kontrate \*\*\*, I. Buletini, me instancë Vlorë - 40;
10. Nr. kontrate \*\*\*, L. Pavarsia Faed, me instancë Vlorë - 40.

✚ **Shoqëria Rajonale UK Vlorë sha**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.08.2023, konfirmon se: Dritan Malaj (atësia mungon) është klient i sha UK Vlorë, me numër kontrate \*\*\*, kabina "Kume 13", subjekt privat, Lagjia "24 Maji". Bashkëlidhur shkresës:

- Faturë tatimore shitje për abonent Korrik 2023; Raport i pagesave të klientit numër \*\*\*; Raport i faturave të klientit numër \*\*\*, që konfirmon se pagesat për vitin 2022 janë në shumën 13.015 lekë.
- ✚ **Shoqëria Rajonale UK Fier sha**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 15.01.2024, konfirmon se: Dritan Malaj ka kontratë nr. \*\*\*, Zona: Patos, Fier (nuk disponohet karta e ID në sistem) dhe për vitin 2022 ka kryer pagesa në shumën 13.248 lekë.
- ✚ **13 Shoqërite Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime**, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Në **proces verbalin e datës 01.12.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaroi se shpenzimet për qira banese për vitin 2022 ishin 20.000 lekë në muaj ose 240.000 lekë në vit dhe ishin për apartamentin e banimit me sip. 63.5 m2, ku jeton aktualisht me qira, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, pallati nr.\*, shkalla \*\*, apartamenti \*\*, Lagjia “\*\*\*\*”, Tiranë, i cili është në gjendje të mobiluar, në pronësi të shtetasit A.S. Kontrata e qirasë ishte 1 (një) vjeçare për periudhën 01.01.2022 - 31.12. 2022, e firmosur nga dy palët e pa noterizuar, për shkak të pamundësisë nga ana shëndetësore e qiradhënësit, shtetasit A.S. Sqaroi se, kjo kontratë qiraje njihet nga Kodi Civil. Kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë janë akoma të lidhura në emrin e shtetasës V.Dh, ish pronaria e këtij apartamenti, e cila i'a ka shitur këtë apartament shtetasit A.S, por shpenzimet për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 janë paguar nga subjekti. Në kontratën e qirasë është e pasqyruar se tatimi mbi pronën dhe tatimi mbi qiranë do të paguhet nga pala qiradhënëse. Theksoi se, shpenzimet për energjine elektrike dhe ujë për vitin 2022, referuar librezave të furnizimit me energji elektrike janë rreth 46.000 lekë, por deklarimi i tyre në vlerën 72.000 lekë është lapsus, pasi këto shpenzime i ka deklaruar me përafërsi duke ju referuar nje vlere rreth 6.000 në muaj.  
Gjatë periudhës që ka punuar në Drejtoritë Vendore të Policive në Rrethe, është akomoduar në ambientet e dhëna nga institucionet ku ka punuar. Në periudhën që punon si zv/ Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, kur qëndron në qytetin e Peshkopisë është akomoduar në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër.  
Gjatë periudhës së viteve 2001 – 2023, që ka punuar në Policinë e Shtetit, ka qënë për 3(tre) muaj në dispozicion të D.P.P. Shtetit, nga data 10.10.2014 deri në 20.01.2015 dhe më pas është emëruar përsëri në detyrë.  
Për konstatimet nga FSHU, deklaroi në përgjegjësi personale dhe ligjore se Dritan Hazir Malaj, i datëlindjes 12.07.1978, me ID \*\*\*, nuk ka lidhur asnjë nga kontratat e konstatuara për furnizimin me energji elektrike.  
Për konstatimin nga Shoqëria Rajonale UK Vlorë sha, deklaroi në përgjegjësi personale dhe ligjore se Dritan Hazir Malaj, i datëlindjes 12.07.1978, me ID \*\*\*, nuk ka lidhur kontratën e sipërcituar për furnizimin me ujë.

**Subjekti paraqiti:**

- Kontratën e qirasë datë 01.01.2022 (e pa noterizuar) për apartamentin e banimit me sip. 63.5 m2, me adresë: Rr. “\*\*\*\*” pallati nr. \*\*, shkalla \*\*, apartamenti \*\*, Lagjia “\*\*\*\*”, Tiranë, me palë qiradhënëse A.S dhe palë qiramarrëse Dritan Hazir Malaj, për periudhën 01.01.2022 - 31.12. 2022, me qira mujore 20.000 lekë. Tatimi mbi pronën dhe tatimi mbi qiranë do të paguhet nga pala qiradhënëse.
- Certifikata për Vërtetim Pronësie për pasurinë me nr. 8/248+ 1-9, apartament me sip. 63.50 m2, me adresë Rr. “\*\*\*\*” P. \*\*, Shk \*\*. Ap. \*\*. Tiranë, në pronësi të shtetasit A.S.
- Kartë identiteti e A.S, me nr, personal \*\*\*;
- Kartë identiteti e Dritan Malaj, me nr. personal \*\*\*;
- Librezë për energjinë elektrike në emrin e shtetasës V.DH, që konfirmon se shpenzimet për vitin 2022 për energjinë elektrike janë në shumën 35.849 lekë;
- Librezë për ujë në emrin e shtetasës V.DH, që konfirmojnë se shpenzimet për vitin 2022 për ujë janë në shumën 10.074 lekë.
- Kontratë Shitje Pasuri e Paluajtshme me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol. datë 27.05.2019, të apartamentit me sip. 63.50 m2, me nr. pasurie 8/248+ 1-9, me adresë Rr. “\*\*\*\*”, P. \*\*, Shk. \*\*, Ap. \*\*, Tiranë, me palë shitëse V.DH dhe pala blerëse A.S. Bashkëlidhur, certifikata për Vërtetim Pronësie.
- Kartelë mjekësore nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë për shetasin A.S. Bashkëlidhur dokumenti nga ISSH.
- Urdhër nr. \*\*\*, datë 07.10.2014, nga Ministria e Punëve të Brendshme, D.P.P. Shtetit për lirim të Dritan Malaj nga detyra dhe kalimin në dispozicion.
- Urdhër nr. \*\*\*, datë 20.01.2015 nga Ministria e Punëve të Brendshme, D.P.P Shtetit për transferimin e Dritan Malaj me detyrë Shef Sektori në Sektorin e Rendit Publik në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier.
- Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 30.11.2023 nga FSHU, që konfirmon se me të dhënat Dritan Hazir Malaj, i datëlindjes 12.07.1978, me ID \*\*\*, nuk ka kontrata të lidhura për furnizimin me energji elektrike me FSHU. Bashkëlidhur, praktika.
- Vërtetimin me nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2023 nga Shoqëria Rajonale UK Vlorë sha. që vërteton se qytetari Dritan Hazir Malaj, me ID \*\*\*, nuk ka lidhur kontrata të furnizimit me ujë me këtë shoqëri.

Nga verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, në Regjistrin Noterial, ka rezultuar se subjekti i vlerësimit, në datën 25.02.2023, ka lidhur një kontratë qiraje me shtetasin A.S, për apartamentin e banimit me sip. 63.5 m2, ku jeton aktualisht me qira, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*, shkalla \*\*, apartamenti \*\*, Lagjia “\*\*\*\*”.

- Me anë të postës elektronike datë 17.01.2024, pranë ILDKPKI, për konstatimin nga Shoqëria Rajonale UK Fier sha, subjekti deklaroi me përgjegjësi të plotë, se nuk ka lidhur asnjë kontratë për furnizim me ujë me këtë shoqëri.

✚ **Vodafone Albania sha**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 03.11.2023, përcjell CD që konfirmon se: Dritan Malaj ka të regjistruar 1 (një) numër celulari: \*\*\*, nga data 19.12.2007, me status: Aktiv. Për vitin 2022, rezultojnë pagesa në shumën 6.000 lekë.

- ✚ **One Albania sha**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon se në emër të Dritan Hazir Malaj, ditëlindja 12.07.1978, ID \*\*\*, nuk rezulton i regjistruar shërbimi i telefonisë mobile, telefonisë fikse/internet, në rrjetin ONE Albania.
  - ✚ **Albania Satellite Communications shpk**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 31.08.2023 nuk konfirmon kontratë të lidhur nga subjekti vlerësimit Dritan Malaj.
  - ✚ **Abissnet sha**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.09.2023 nuk konfirmon kontratë të lidhur nga subjekti vlerësimit Dritan Malaj.
  - ✚ **Digicom sha**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, konfirmon se Dritan Hazir Malaj, nuk ka marrë shërbim interneti nga shoqëria Digicom, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.
- **Në proces verbalin e datës 01.12.2023**, mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaroi se, përveç numrit celular \*\*\*, për të cilin ka lidhur kontratë me Vodafone Albania sha, ka të regjistruar edhe numrin celular \*\*\*, të cilin e ka blerë para disa vitesh kur punonte në Drejtorinë e Antiterrorit. Këtë numër nuk e ka regjistruar në emrin e tij dhe nuk dispononte kontratë të lidhur me kompaninë ONE. Për numrin celular \*\*\* për vitin 2022, ka kryer pagesa (mbushje) në shumën rreth 6.000 lekë dhe për këtë arsye ka deklaruar shpenzime telefoni në shumën 12.000 lekë. Subjekti ka kërkuar në kompaninë ONE, për të marrë faturën e pagesave për vitin 2022, por e kanë sqaruar se meqenëse nuk ka kontratë të lidhur për këtë numër në emrin tij, kompania nuk mund ta pajisë me faturë pagesash për të konfirmuar shpenzimet për këtë numër për vitin 2022. Subjekti sqaroi se, numrin celular \*\*\* do ta mbylli së shpejti, pasi ka pasur pakënaqësi me shërbimin e kësaj kompanie.
  - ✓ **Shpenzimet për ujë + drita + telefoni + internet gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022, janë në shumën rreth 58.000 lekë, ndërsa shpenzimet për qira banese në shumën 240.000 lekë.**
  - ❖ **Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022**
8. Gjatë 3 viteve të fundit kam një dalje në territorin e Kosovës, datë 04.11.2022, nga PKK Morinë për të shkuar në Gjakovë, Komuna Shishman, për rast vdekje. Shuma e shpenzuar 12.000 lekë.
- **Në proces verbalin e datës 01.12.2023**, mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaroi se shpenzimi i deklaruar për daljen 1 (një) ditore në territorin e Kosovës në datë 04.11.2022, në shumën 12.000 lekë, ishte për një drekë që subjekti ka konsumuar me të afërmit e tij, për arsye të vdekjes së një të afërmi në Gjakovë, Komuna Shishman, si dhe shpenzime për karburantin e

automjetit në pronësi të një të afërmi të tij, me të cilën ka shkuar dhe është kthyer nga Kosova. Nuk dispononte dokumenta justifikues lidhur me këto shpenzime.

**Subjekti paraqiti:**

- Dokumentin nga sistemi TIMS, që konfirmon daljen e subjektit në Kosovë në datën 04.11.2022.
  - ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje – daljeve nga RSH të subjektit për periudhën e sipërcituar.**
  - ✓ **Shpenzimet e subjektit për vitin 2022 për lëvizjet jashtë territorit të RSH për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022, janë deklaruar në vlerën 12.000 lekë.**
9. Në deklaratën e Pasurisë për Vlerësimin Kalimtar, nga subjekti Dritan Malaj, në rubrikën "Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në Gjëndjen Civile" është deklaruar: Rr. "\*\*\*\*" nd. \*\*, ap. \*\*, Njësia Administrative nr. \*, Tiranë.
- Në rubrikën "Nëse disponon vendqëndrim tjetër" është deklaruar: Lagjia "\*\*\*\*", Rruga "\*\*\*\*", Pall. \*\*, Shk. \*\*. Ap. \*\*, Tiranë.

**Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë qiraje me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 25.02.2023, për apartament banimi me sip. 63.5 m2, me adresë Rr. "\*\*\*\*", me palë qiradhënëse shtetasin: A.S dhe palë qiramarrëse shtetasin: Dritan Malaj, për periudhën 25.02.2023 - 25.02.2024, me qira mujore: 20.000 lekë. Palët deklarojnë se në marrëveshje midis tyre, kanë rënë dakort që detyrimet ndaj shtetit që lidhen me efektet e kësaj kontrate të paguhen si vijon: "Tatimi mbi pronën dhe tatimi mbi qiranë do të shlyhet nga pala qiradhënëse"
  - Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. \*\*\*, datë 14.06.2019, për apartament me sip. 63.50 m2, zk. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, volumi \*\*\*, fq. \*\*\*, Rr. "\*\*\*\*", Godina \*\*, hyrja \*\*, apartamenti nr. \*\*, Tiranë, në pronësi të shtetasit A.S.
  - Kartela e pasurisë datë 14.06.2019, për apartament me sip. 63.50 m2, Rr. "\*\*\*\*", P/G \*\*, Shk. \*\*, K. \*\*, Ap. \*\*, Tiranë, në pronësi të shtetasit A.S.
  - Harta e regjistrimit për apartamentin me sip. 63.50 m2, zk. \*\*\*, nr. Pasurie \*\*\*, volumi \*\*, fq. \*\*, Tiranë, në pronësi të shtetasit A.S.
  - Kartë identiteti e A.S, me nr. personal \*\*\*.
  - Kartë identiteti e Dritan Malaj, me nr. personal \*\*\*.
- **Në proces verbalin e datës 01.12.2023**, mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaroi se në adresën që është i regjistruar në gjendjen civile, ka jetuar me qira bashkë me babain H.M dhe motrat nga viti 2008, e cila ishte në pronësi të shtetasit Sh.B, i datëlindjes 31.12.1933. Në atë periudhë, kontrata e qirasë ishte lidhur nga babai i subjektit H.M dhe qiraja paguhej prej tij. Pas vdekjes së babait në vitin 2015, kontrata e qirasë ka vazhduar në heshtje dhe tek kjo banesë subjekti ka jetuar me qira deri në fund të vitit 2021. Nuk disponon kontratë qiraje apo dokument pronësie

lidhur me këtë banesë, pasi kontrata e qirasë ishte e lidhur nga babai i tij. Për deklarin e adresës së banimit ku është i regjistruar në gjendjen civile, subjekti i është referuar certifikatës personale datë 27.02.2023, ku pasqyrohet adresa: Rr. "\*\*\*\*" nd. \*\*, H. \*\*, ap. \*\*, Njësia Administrative nr. \*, Tiranë.

Për adresat e banimit të deklaruara në deklaratat e interesave privatë ndër vite:

- Njësia Administrative nr. \*, Lagjia nr. \*\*, Rruga "\*\*\*\*", Pallati nr. \*\*;
- Rruga "\*\*\*\*", Pallati nr. \*\*, sqaroi se:

Në adresën Njësia Administrative nr. \*, Lagjia nr. \*\*, Rruga "\*\*\*\*", Pallati nr. \*\*, kanë banuar fillimisht me qira me babain dhe motrat, nga viti 1998 dhe tek kjo adresë ishte i regjistruar fillimisht në gjendjen civile. Për këtë adresë banimi, kontrata e qirasë ishte bërë nga babai H.M dhe shpenzimet mujore të qirasë ishin rreth 15.000 lekë në muaj, të cilat mbulohehin me të ardhurat familjare të babait. Nuk disponon kontratë qiraje apo pronësie për këtë adresë banimi, pasi kanë kaluar shumë vite dhe kontrata e qirasë ishte lidhur nga babai i tij.

Në adresën Rruga "\*\*\*\*", Pallati nr. \*\*, Tiranë, e cila kryqëzohej me Rr. "\*\*\*\*", Njësia Administrative nr. \*\*. Tiranë, janë zhvendosur familjarisht në vitin 2008 dhe është e njëjta banesë (apartament) i cili është në pronësi të shtetasit Sh.B, i datëlindjes 31.12.1933. Për këtë apartament shpenzimet mujore të qirasë ishin 20.000 lekë në muaj. Sqaroi se, pas vitit 2015 pagesat e qirasë janë mbuluar nga subjekti.

- ✓ Subjekti dha sqarime lidhur me adresën e banimit të regjistruar në gjendjen civile dhe adresat e banimit të deklaruara ndër vite.
- ✓ Shpenzimet e qirasë për perindhën 2015 - 2021 janë në shumën 1.680.000 lekë.
- ✓ Shpenzimet e qirasë për periudhën janar - shkurt 2023 janë në shumën 40.000 lekë.

#### **Gjithashtu, bashkëlidhur deklaratës:**

- Kartë identiteti e Dritan Malaj me nr. personal \*\*\*.
- Certifikatë familjare nga Bashkia Tiranë, Njësia Bashkiake nr. \*\*, dt. 27.02.2023, e Dritan Malaj, me vulë elektronike.
- Certifikatë personale datë nga Bashkia Tiranë, Njësia Bashkiake nr. \*\*, dt. 27.02.2023, e Dritan Malaj, me vulë elektronike.
- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 06.03.2023, nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, që konfirmon se z. Dritan Malaj, me detyrë zv/ Drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, në zbatim të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 6, datë 17.01.2023, si dhe Udhëzimit të përbashket nr. 15, datë 27.01.2023, të Ministrit të Brendshëm me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si subjekti i ligjit ka dorëzuar dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular për deklarinimin e pasurisë.
2. Formular për kontrollin e figurës.
3. Formular për vlerësimin profesional.
4. Dokumenta shoqëruese, printim original dhe fotokopje.

## HETIMI ADMINISTRATIV

✚ **Banka e Shqipërisë, BKT, Intesa Sanpaolo Bank, Tirana Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, ABI Bank, Credins Bank, Union Bank, OTP Bank, Raiffeisen Leasing, Porche Leasing, Albania Leasing, Landesleasing, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar i Tiranës, Easypay, Fondi Besa, Insitucioni Financiar NOA, Iute Credit Albania, Kredo Financë**, konfirmojnë se subjekti Dritan Malaj, nuk është klient i tyre, çka konfirmohet me deklarinimin.

✚ **Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Tirana Veri, Tirana Jug, Zonat e Stimuluara, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Librazhd, Mallakastër, Fier, Gjirokastrë, Devoll, Lushnje, Korçë, Berat, Pogradec, Kukës, Kavajë, Gramsh, Malësi e Madhe, Kuçovë, Kamëz Vorë, Pukë, Peqin, Skrapar, Durrës, Bulqizë, Has, Kolonjë, Mirditë, Tropojë, Tepelenë, Përmet, Mat, Shkodër, Vlorë, Sarandë, Krujë, Kurbin, Dibër, Lezhë**, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit.

✚ **ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan**, me shkresën nr. \*\*\*, date 05.10.2023, konfirmon se Dritan Hazir Malaj, ka pasur të regjistruar në bashkëpronësi dhe e ka tjetërsuar me kontratë shitje pasurinë: Apartament me sip. 66 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, zk. \*\*\*, vol. \*\*, faq. \*\*, pallati \*\*, shk. \*\*, ap. \*\*, Elbasan, përfituar me dëshmi trashëgimie dhe tjetërsuar me kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 23.12.1997. Bashkëlidhur:

- Kartelë pasurie për apartament me sip. 66 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, zk. \*\*\*, vol. \*\*, faq. \*\*, Pallati \*\*, Shk. \*\*, K. \*\*, Ap. \*\*, Rr. “\*\*\*\*”, Elbasan, në bashkëpronësi të H.M, R.M dhe Dritan Malaj.
- Kontratë shitje banese nr. \*\*\*, datë 27.12.1993, për apartament 2+1, ap.\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, Elbasan, me palë shitëse: N.K. Banesa Elbasan dhe palë blerëse: H. Malaj, në vlerën 19.720 lekë.
- Vendim nga Gjykata e Rrethit Elbasan, datë 01.06.1996, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen F.M, duke përcaktuar trashëgimtarë ligjor H.M, R.M, Dritan Malaj dhe B.M.
- Kontratë shitje me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 23.12.1997, për apartamentin e banimit i ndodhur në pallatin \*\*\*, ap. \*\*, me palë shitëse: H.M, Dritan Malaj, R.M dhe B.M, si dhe palë blerëse: S.H në vlerën 1.300.000 lekë.



- Në proces verbalin e datës 01.12.2023, mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaroi se të gjitha veprimet për privatizimin dhe më pas shitjen e apartamentit me sip. 66 m<sup>2</sup>, në qytetin e Elbasanit, janë kryer nga i ndjeri, babai i tij H.M dhe për këtë arsye nuk e ka përmendur këtë pasuri në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar. Të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti në vitin 1997 janë menaxhuar nga babai i subjektit H.M, pasi nëna F.M i kishte ndërruar jetë dhe subjekti në atë periudhë ishte në moshën 19 vjeçare dhe jetonte me familjen e tij, babain dhe motrat. Sqaroi se nuk ka përfituar pjesë takuese nga të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti.
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me përgjigjen e ASHK, për apartamentin e përfituar nga babai nga privatizimi dhe të shitur në vitin 1997, në Elbasan.**
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, përcjell CD që konfirmon se Dritan Malaj, në datë 03.08.2010 ka kredituar në llogari shumën 130.000 lekë, ndërsa në datë 15.06.2011, ka kredituar në llogari shumën 160.000 lekë.  
Në vitin 2018 ka kryer 3 (tre) pagesa për tarifë shkollimi në Universitetin e Tiranës Fakulteti i Drejtësisë, në shumën 125.770 lekë dhe 1 (një) pagesë për tarifë shkollimi në Universitetin e Tiranës Fakultetin e Drejtësisë, për shtetasin O.B, në shumën 3.470 lekë.
- Në proces verbalin e datës 01.12.2023, mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaroi se likuiditetet e kredituara në llogarinë e pagës në Raiffeisen Bank në datat 03.08.2010 dhe 15.06.2011, në shumën 130.000 lekë dhe 160.000 lekë, ishin pjesë e kredive që nuk i kishte shpenzuar (me sa i kujtohej) dhe i kishte në gjendje cash në shtëpi. Këto shuma i ka derdhur përsëri në bankë me qëllim mbyllje kredie.  
Pagesat e kryera në vitin 2018, i ka kryer për tarifën e studimeve në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, të cilin e ka ndjekur part-time. Në total, pagesat që ka kryer për të likuiduar tarifën për të ndjekur studimet part - time në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, ishin rreth 126.000 lekë. Për pagesën e kryer për llogari të shtetasit O.B, sqaroi se ky shtetas është shoku i tij, i cili edhe ai ndiqte Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, part-time.

### **Subjekti Paraqiti:**

- Diplomë datë 17.12.2020 nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, të Dritan Hazir Malaj, i datëlindjes 12.07.1978.
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me përgjigjen e RFZ Bank, për tarifën e shkollimit për studimet part – time, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë në shumën rreth 126.000 lekë.**
- ✚ **AK Invest**, me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 21.08.2023, konfirmon se shtetasi Dritan Malaj, i datëlindjes 12.07.1978, nuk ka kryer transaksione bankare nëpërmjet rrjetit Ak- Invest sh.a.

Shtetasi me emrin Dritan Malaj, për të cilin nuk ka të dhëna për të vërtetuar gjeneralitetet e tij, ka kryer 2 (dy) transfertat monetare si përfitues, si vijon:

- Tërheqje MG; referenca \*\*\*; datë 09.11.2011; shuma 50 euro; emri i marrësit Dritan Malaj; shteti i marrësit: Shqipëri; emri i dërguesit I.A, shteti i dërguesit: Greqi.
  - Tërheqje MG; referenca \*\*\*; datë 05.06.2013; shuma 500 euro; emri i marrësit Dritan Malaj; shteti i marrësit: Shqipëri; emri i dërguesit D.B, shteti i dërguesit: Itali.
- Në proces verbalin e datës 01.12.2023, mbajtur nga ILDKPKI, subjekti deklaroi në përgjegjësinë personale dhe ligjore se, Dritan Hazir Malaj i datëlindjes 12.07.1978 me ID \*\*\*, nuk ka kryer transfertat parash nga ky institucion.

✓ **Subjekti dha sqarime lidhur me konstatimin nga AK Invest.**

✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.08.2023, nuk konfirmon automjete në pronësi të subjektit Dritan Hazir Malaj.

✚ **QKB**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.08.2023, konfirmon se për periudhën deri në 06.03.2023, shtetasi Dritan Malaj, nuk figuron të jetë pajisur me NUIS (NIPT), si persona fizik apo të zoterojë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruar pranë regjistrimit tregtar.

✚ **DPT**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.08.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Dritan Malaj, konstatohet si vijon:

Dritan Malaj, NIPT \*\*\*; Drejtoria Rajonale Tatimore Fier; Administrator; Data e hapjes: 18.04.2006.

Dritan Malaj, NIPT \*\*\*; Drejtoria Rajonale Tatimore Fier; Administrator; Data e hapjes: 18.04.2006;

Dritan Malaj, NIPT \*\*\*; Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore; Administrator; Data e hapjes: 18.04.2006.

✚ **DRT Fier**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 28.08.2023, konfirmon se shtetasi Dritan Hazir Malaj, identifikuar me nr. personal \*\*\*, nuk rezulton i regjistruar si biznes në DRT Fier, deri në datë 22.08.2023.

Shënim: Tatimpaguesi Dritan Malaj, Person Fizik me NIPT \*\*\*, i përket shtetasit Dritan Xh. Malaj, i datëlindjes 29.05.1978.

Tatimpaguesi Dritan Malaj, Person Fizik me NIPT \*\*\*, i përket shtetasit Dritan Xh.Malaj, i datëlindjes 1975.

✚ **DRT Vlorë**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 29.08.2023, konfirmon se për periudhën deri në datë 06.03.2023:

- Në emër të individit Dritan Hazir Malaj, i regjistruar me nid \*\*\*, nuk ka biznes të regjistruar pranë DRT Vlorë.

- Nuk ka të dhëna të regjistruara për periudhën deri në datë 06.03.2023, për individin Dritan Hazir Malaj, i regjistruar me nid \*\*\*.

** Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 11.08.2023, nuk konfirmon mjete lundruese në pronësi të Dritan Malaj.

- ❖ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;
- Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 06.03.2023, është deklaruar bruto/neto 1.880.000 lekë.
- Të ardhurat e subjektit, konfirmohen për periudhën gusht 2001 - mars 2023, në vlerën totale rreth 22.043.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet, në total rreth 58.000 lekë dhe për qira banese rreth 240.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtimet private, personale në shumën 12.000 lekë.
- Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimin e subjektit, në total rreth 126.000 lekë.
- Për periudhën 16.08.2001 - 06.03.2023, referuar treguesve statistikore të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum personal, rreth 3.748.000 lekë.
- Shpenzimet e qirasë për periudhën 2015 - 2021 janë në shumën 1.680.000 lekë, ndërsa për periudhën janar - shkurt 2023 janë në shumën 40.000 lekë.

#### **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mblendhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Dritan Hazir Malaj:

- ✓ *Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;*
- ✓ *Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- ✓ *Nuk është kryer fshehje e pasurisë;*
- ✓ *Nuk është kryer deklaram i rremë;*
- ✓ *Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interes*

## B. KONTROLLI I FIGURËS

✚ Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Dritan Hazir Malaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës” të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit Z. Dritan Malaj, në zbatim të nenit 36, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- b. Raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit, nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2023, të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ **Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit**, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar

raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës, të subjektit të vlerësimit, nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2023, ku ka konstatuar se:

a) **Subjekti i vlerësimit z. Dritan Hazir Malaj, me detyrë Zv/Drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

**Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:**

- Nuk ka pasur emër dhe mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur me ndonjë nofkë, emër dhe mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar.
- Nuk ka pasur nënshtetësi tjetër.
- Nuk është dënua ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk ka qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një veprë penale.
- Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale
- Ndaj tij nuk është lëshuar ndonjëherë një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk ka marrë ndonjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka dijeni se një anëtar i familjes suaj është përfshirë/dyshohet për përfshirje në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka dijeni që një nga anëtarët e familjes ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një anëtar i familjes ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s, gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk ka pasur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqtrajtuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.

- Nuk ka kryer shkelje sigurie apo nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar si dhe as tentuar apo kryer aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka qënë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit.

Subjekti ka nënshkruar dy vetëdeklarime për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

### **Hetimi Administrativ**

- Trupa e Vlerësimit, në mbështetje të neneve 35 – 42, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse dhe raportit nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, ka kryer hetimin mbi kontrollin e figurës dhe saktësinë e deklaratimit të subjektit të vlerësimit, **nga ku konstatoi se:**
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 15.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Malaj, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 28.07.2023, bën me dije se subjekti i vlerësimit Z. Malaj, nuk rezulton i dënuar.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. \*\*\* prot., bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Malaj, nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo në veprimtari të kundraligjshme
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 11.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Malaj, nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen e tij në aktivitete e tij në aktivitete të kundërligjshme.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 04.08.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Malaj, nuk figurojnë informacione të regjistruara për veprimtari kriminale.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 09.08.2023, shkresën nr. \*\*\* prot. datë 03.10.2023 dhe shkresën nr. \*\*\* prot. datë 16.08.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Malaj nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshëm dhe nuk ka procedime penale të referuara.
- ✚ **Institucionet ligjzbatues**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 27.09.2023, shkresën nr. \*\*\* prot. datë 11.08.2023 dhe shkresën nr. \*\*\* prot. datë 07.05.2024, se për subjektin e vlerësimit Z. Malaj nuk është nxjerrë urdhër ndalimi, nuk është kërkuar masë e sigurimit personal (masa

shtrënguese/masa parandaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227 të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale sipas përcaktimi të nenit 278 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

- ✚ **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, më shkresën nr. \*\*\* prot. datë 31.07.2023, se subjekti i vlerësimit Z. Malaj, është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), në nivelin "Tepër Sekret" lëshuar me datë 30.06.2023, e vlefshme deri më datë 29.06.2028. Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
- ✚ **Avokati i Popullit**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 14.08.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Malaj, nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës si dhe nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
- ✚ **Në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**, për subjektin e vlerësimit Z. Malaj, nuk ka denoncime nga publiku dhe nuk disponohen ankesa për të.

#### ✚ **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë, ka kryer në datën 19.03.2024, testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara nga Ekzaminimi Toksikologjiko – Ligjor, për përdorim lëndësh narkotike, nga Instituti i Mjekësisë Ligjore nr. \*\*\* datë 23.03.2024, konkludohet se subjekti vlerësimit **Z. Dritan Hazir Malaj**,

- **Akualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.**

#### ✚ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Dritan Hazir Malaj:

- ✓ **Ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;**

- ✓ *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

- ✚ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:
- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
  - raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar
- ✚ Subjekti i vlerësimit Z. Dritan Malaj, më datë 06.03.2023, ka dorëzuar në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1, të Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
- ✚ Në dispozitën e Nenit 44, pika “2” dhe “3” të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, është përcaktuar se: “Periodha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet” dhe “Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban, periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës”.
- ✚ Subjekti i vlerësimit **Z. Dritan Malaj** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Zëvendësdrejtorit për Hetimin e Krimit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër.
- ✚ Struktura e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 46, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar raportin e vlerësimi profesional, të subjektit të vlerësimit, nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, ku në konkluzionin përfundimtar, shprehet se:



- a) **“Punonjësi i policisë z. Dritan Hazir Malaj është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.**

## Hetimi Administrativ

- Trupa e Vlerësimit, në mbështetje të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe bazuar në të dhënat e administruara në dosjen e subjektit të vlerësimit, të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, ka kryer hetimin e plotë mbi aftësitë profesionale të subjektit të vlerësimit, **nga ku është konstatuar si më poshtë:**

### **1. Niveli i arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:**

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2, gërma a e Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

- ❖ Në Formularin e Aftësive Profesionale të plotësuar nga subjekti ka rezultuar se ka kryer studimet si më poshtë:
- 2009 – 2020 – Studime e Larta në Universitetin e Tiranës, Diplomë Bachelor në Drejtësi.
- 1998 – 2001 – Studimet e Larta në Akademinë e Policisë, Tiranë, Titulli Specialist i Lartë Policie.

## Hetimi Administrativ

✚ Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit ka rezultuar:

- Kopje e Diplomës së Shkollës së Lartë, në Akademinë e Policisë, me vendim të komisionit shtetëror nr. \*\*\* datë 23.07.2001, nr i regjistrit \*\*\*.
  - Kopje e Diplomës së studimeve Bachelor në Drejtësi, në Universitetin e Tiranës, nr. \*\*\* datë 17.12.2020.
- ✓ **Në kuptim të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar rezulton se subjekti i vlerësimit, për periudhën e përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, sipas ecurisë së tij në karrierë, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor për**

## **funksionet që ka ushtruar në vite dhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.**

### **2. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:**

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, përcaktohet se: “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 (pesë) vjet”.

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është ecuria në karrierë dhe fitimi i gradave, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma dh, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

#### **Hetimi Administrativ**

- ✚ Subjekti i vlerësimit Z. Dritan Malaj, ka një karrierë në Policisë e Shtetit prej 21 vitesh e 11 muaj. Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit rezultojnë se 5 (pesë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:
  - Nga data 01.03.2016 deri më 12.11.2021, ka kryer detyrën e Specialistit të Drejtimit, në Sektorin e Hetimit dhe Koordinimit, në Drejtorinë e Antiterrorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
  - Nga data 12.11.2021 dhe aktualisht, ka kryer detyrën e Zv/Drejtorit për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër.
- ✚ Nga aktet e dosjes së personelit, rezultojnë se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklaratimit ka përfituar gradat policore si më poshtë:
  - **Grada Kryekomisar** sipas urdhrit nr. \*\*\*, datë 18.06.2014, “Për dhënien e gradës policore të një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
  - **Grada Drejtues** sipas urdhrit nr. \*\*\*, datë 28.07.2016, “Për dhënien e gradës policore të një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- ✓ **Pas kontrollit dhe verifikimit me dokumentacionin e sipërpërmendur, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit Dritan Malaj, arrijmë në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

### **3. Vlerësimet e punës:**

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë vlerësimet e punës, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma ç, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

### Hetimi Administrativ

✚ Në dosjen personale të subjektit të vlerësimit për periudhën 2018 – 2022, janë administrua 5 (pesë) vlerësime të aftësive individuale të punës. Nga administrimi i këtyre akteve, rezulton se gjatë 5(pesë) viteve të fundit, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga punëdhënësit për rezultate individuale të punës me vlerësimin “**Shumë Mirë**”.

Vlerësimet përkatëse si vijon:

▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018	27 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019	28 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020	“ <i>nuk është i administruar në dosje</i> ”	
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021	28 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022	28 Pikë	(shumë mirë)

✚ **Avokati i Popullit**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 14.08.2023, nuk konfirmon të ketë pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Dritan Malaj.

✚ **Pranë AMP-së**, nuk kanë ardhur denoncime apo ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

✓ **Bazuar në vlerësimet e sipërmendura, të administruara në dosjen personale të subjektit, arrihet në konkluzionin se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale dhe funksionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.**

### 4. Respektimi i rregullave të etikës:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë masat disiplinore, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma d, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

### Hetimi Administrativ

✚ Nga verifikimi në dosjen personale dhe sistemin RMIS, rezultoi se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, (2018 - 2023), subjekti i vlerësimit Z. Dritan Malaj nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Gjithashtu, nga verifikimi i dosjes personale, bazuar në vlerësimet e aftësive individuale të punës nga eprorët ndër vite, në lidhje me respektimin e rregullave të etikës, ka rezultuar se: subjekti shfaq integritet dhe standarde të larta etike, është shembull i mirë për organizatën.

✓ **Nga verifikimet e kryera arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.**

## **5. Kualifikimet dhe trajnimet:**

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë certifikatat e trajnimeve dhe medaljet, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma c, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

### **Hetimi Administrativ**

✚ Nga verifikimi dosjes personale si dhe pikës 3, të pjesës 3, të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit, si më poshtë:

- Trajnim në vitin 2017, Parashikimi i radikalizmit që con në terrorizëm dhe masat parandaluese;
- Trajnim në vitin 2017, Taktikat dhe metodat në fushën e superterrorizmit;
- Trajnim në vitin 2018, Rritjen e Aftësisë Teknike dhe Hetimore të Njësive të Hetimit të Antiterrorit;
- Trajnim në vitin 2018, Të drejtat e njeriut në Hetimin e Antiterrorizmit;
- Trajnim në vitin 2018, Forumi Ekzekutiv mbi konsultimin për luftëtarët e huaj Terroristë.

Pavarësisht trajnimeve të kryera nga subjekti, përgjatë periudhës sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti ka kryer edhe një sërë trajnimesh të tjera përgjatë karrierës së tij, të cilat janë të lidhura me thellimin e njohurive, shtimin e vlerave dhe rritjen e performancës në ushtrimin e profesionit të profilit të tij.

✓ **Nga verifikimet e kryera arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.**

## **6. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, ëorkshope, botime.**

✚ Subjekti i vlerësimit Z. Dritan Malaj, në Formularin e Aftësive Profesionale, ka deklaruar se për periudhën objekt vlerësimi, nuk është angazhuar në Konferenca Shkencore, Ëorkshope, Seminare, Botime, brenda dhe jashtë vendit.

✚ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit si

dhe verifikimin mbi përmbushjen e detyrave funksionale, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Dritan Hazir Malaj:

- ✓ Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- ✓ Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;
- ✓ Ka vlerësime pozitive pune.

### **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR:**

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Dritan Hazir Malaj, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

### **PËR KËTO ARSYE:**

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Dritan Hazir Malaj**, me funksion Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 11.07.2024, në Tiranë.

### **TRUPA E VLERËSIMIT**

**Kryesues**

**Denisa SINA**

**Relator**

**Suela BULKU**

**Anëtar**

**Arben SEFAJ**